



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 27, datë 28.04.2015

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, NUMRIN E PUNONJËSVE DHE
PËRSHKRIMET E PUNËS SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 10 dhe nenit 9, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,


V E N D O S I :

1. Miratimin e strukturës organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimet e punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare , sipas anekseve 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Numri i punonjësve sipas kësaj strukture do të plotësohet deri në vitin 2019.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI



ANEKS 1 Struktura organizative dhe numri i punonjësve në
Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Struktura	Pozicioni	Nr. punonjësve 2015		Nr. punonjësve deri ne vitin 2019
Bordi i Autoritetit	Drejtori Përgjithshëm Ekzekutiv	1		1
	Nendrejtor Ekzekutiv	1		1
Sekretaria e Bordit				
	Specialist	1		1
Kabineti				
	Këshilltar	2		2
	Sekretar i titullarit	1		1
Auditi i Brendshëm	Audit i profilit të përgjithshëm financiar	1		1
	Audit i teknologjisë së informacionit dhe vlerësimit të riskut			1
Departamenti i Mbikëqyrjes Financiare				
	Drejtor	1		1
Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve				
	Drejtor	1		1
Sektori i Mbikëqyrjes së Sigurimit/ Risigurimit të Jo- Jetës dhe Grupeve të Sigurimit				
	Përgjegjës sektori	1		1
	Specialistë	5		8
Sektori i Mbikëqyrjes së Sigurimit/ Risigurimit të Jetës				
	Specialistë	2		3
Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve të Pensionit, të Tregut të Fondeve të Investimit dhe të Tregut të Titujve				
	Drejtor	1		1
Sektori i Mbikëqyrjes së Fondeve të Pensionit				
	Specialistë	2		2
Sektori i Mbikëqyrjes së Fondeve të Investimit dhe Tregut të Titujve				
	Përgjegjës sektori	1		1
	Specialistë	2		4
Drejtoria e Analizës së Riskut				
	Drejtor	1		1
Sektori i Aktuaristikës				
	Përgjegjës sektori	1		1

	Aktuar	2		2
Sektori i Modelimeve Financiare				
	Specialistë	1		3
Departamenti i Zhvillimeve Strategjike, TI, Statistikës				
	Drejtor	1		1
Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike , Statistikës dhe Medias				
	Drejtor	1		1
Sektori i Zhvillimeve Strategjike dhe Projekteve				
	Përgjegjës sektori			1
	Specialistë	2		3
Sektori i Statistikës				
	Specialistë	2		2
Sektori i Komunikimit me Median dhe Publikun				
	Përgjegjës sektori	1		1
	Specialistë	2		2
Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë				
	Specialistë	1		2
Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit				
	Drejtor	1		1
Sektori i Programimit, Zhvillimit Inteligent dhe Mirembajtjes				
	Specialistë	2		3
Qendra e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme				
	Specialistë	1		3
Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve				
	Drejtor	1		1
Sektori i Licencimit				
	Përgjegjës sektori			1
	Specialistë	2		2
Sektori i Monitorimit të Ndërmjetësve				
	Përgjegjës sektori			1
	Specialistë	2		2
Departamenti i Çështjeve Juridike				
	Drejtor	1		1
Drejtoria e Zbatueshmërisë				
	Drejtor	1		1
Sektori i Zbatueshmërisë				
	Specialistë	2		2
Sektori i Mbrojtjes Konsumatore dhe Investitorëve				
	Specialistë	1		2

Drejtoria Juridike				
	Drejtor	1		1
Sektori i Çështjeve Juridike dhe Pajtueshmërisë				
	Specialistë			2
Sektori i Hartimit të Akteve Rregullatore				
	Përgjegjës sektori			1
	Specialistë	2		3
Drejtoria e Rregullimit dhe Standardeve				
	Drejtor	1		1
	Specialistë	2		2
Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme				
	Drejtor	1		1
Sektori i Administrimit Financiar				
	Përgjegjës sektori	1		1
	Specialistë	2		2
Sektori i Burimeve Njerëzore				
	Specialist	1		1
	Specialist	1		1
Sektori i Prokurimeve dhe Shërbimeve				
	Përgjegjës sektori	1		1
	Specialist	1		1
	Specialist	1		1
	Shoferë	3		3
	Punonjës Pastrimi	1		2
Qendra e Edukimit				
	Drejtor	1		1
	Specialistë			2
Gjithsej		72		97

Shënim: Numri I punonjësve për vitin 2015 do të jetë 72.
Numri I punonjësve deri në vitin 2019 do të jetë 97.

ANEKS 2

Mbi përshkrimin e punës të Departamenteve dhe Drejtorive në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Departamentet dhe Drejtoritë

1. Departamenti i Mbikëqyrjes Financiare

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

- Realizon ciklin e mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimeve/risigurimeve, ku përfshihet: *off-site* dhe *on-site*;
- Zbaton mbikëqyrjen me bazë risku;
- Ngre sisteme të paralajmërimit të hershëm;
- Drejton analizat financiare sipas standarteve të raportimit financiar;
- Realizon ciklin e mbikëqyrjes së grupeve të sigurimit;
- Bashkëpunon me rregullatore dhe mbikëqyrës të tjerë në vend dhe jo vetëm sipas memorandumeve / marrëveshjeve në fuqi.

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve të Pensionit, të Tregut të Fondeve të Investimit dhe të Tregut të Titujve

- Realizon ciklin e mbikëqyrjes *off-site* dhe *on-site* të shoqërive të licencuara në tregun e fondeve të pensioneve vullnetare (shoqëri administruese, depozitare, fonde pensioni);
- Realizon ciklin e mbikëqyrjes *off-site* dhe *on-site* të shoqërive të licencuara në tregun e fondeve të investimeve (shoqëri administruese, depozitare, fonde investimi);
- Ndjek likuiditetin dhe mënyrën e vlerësimit të aseteve tek fondet e investimit;
- Drejton analizat financiare sipas standarteve të raportimit financiar për shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në tregun e fondeve të pensioneve vullnetare, të fondeve të investimeve dhe tregun e titujve;
- Bashkëpunon me rregullatore dhe mbikëqyrës të tjerë në vend dhe jo vetëm sipas memorandumeve / marrëveshjeve në fuqi.

Drejtoria e Analizës së Riskut

- Kryen shërbimin aktuarial dhe modelimet financiare për të tre tregjet;
- Merr pjesë në analizën dhe mbikëqyrjen financiare të tre tregjeve (*on-site*);
- Vlerëson modelete riskut të shoqërive të sigurimeve;
- Vlerëson modele të tjera ekonometrike për tregjet e kapitalit, modeli (*yield curve*);
- Kryen analiza në shërbim të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar;
- Vlerëson përshtashmërinë e kontratave dhe marrjen në sigurim nga pikëpamja e saktësisë së përlllogaritjeve të primeve, shumave të siguruara;
- Vlerëson programet e risigurimit,
- Shqyrton programet e investimeve, tabelat e mortalitetit dhe in floë dhe outfloë të produkteve të sigurimit të jetës;
- Vlerëson kontratat/prospektuset në funksionet e ligjit të pensioneve dhe SIK;
- Realizon analiza të ndërveprimit të tregjeve, mbikëqyrjes së integruar, prodhimin e vlerësimeve në kuadër të FSAP, etj.

2. Departamenti i Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës

Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias

- Ndjek aspektin zhvillimor në funksionet e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve;
- Drejton studimet, kërkimet, projektet, analizat e tregjeve që mbikëqyren nga AMF;
- Harton strategji në funksion të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje;
- Kryen vetëvlerësimin e AMF-së, të riskut të manaxhimit institucional si dhe kryen vlerësimin e sistemit financiar nën mbikëqyrje të AMF-së në kuadër të FSAP dhe misioneve të Bankës Botërore dhe FMN;
- Përgatit përmbajtjen e publikimeve të AMF (Raporte Vjetore, Periodike);
- Përgatit informacione në lidhje me përfaqësimin e AMF-së në GKSF;
- Administron marrëdhëniet me publikun dhe median;

- Bashkëpunon me organizmat ndërkombëtare ku AMF është anëtare, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë dhe autoritete vendë të tjera;
- Organizon përfaqësimin e Autoritetit në konferenca, seminare, takime brenda dhe jashtë vendit;
- Mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore nga subjektet që operojnë në të tre tregjet;
- Informon dhe komunikon me median dhe publikun;
- Realizon përshtatjen dhe zhvillimin e paketave raportuese si dhe konceptimin dhe prodhimin e gjithë statistikave.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (TI)

- Realizon funksione programuese, zhvilluese;
- Mirëmban sistemet, në veçanti sistemin AMF InReg (administrimi i platformës së raportimit online me subjektet e mbikëqyrura dhe zhvillimi i formateve të raportimit);
- Përpunon dhe nxjerr informacione dhe raporte nga portalet në interes të mbikëqyrjes së tregjeve;
- Mirëmban arkitekturën ekzistuese të rrjetit kompjuterik në AMF;
- Mbështet projektet software dhe hardware;
- Përgjigjet për sistemet e backup-it, të sigurisë dhe vazhdimësisë së punës dhe proceseve;
- Administron të dhënat në lidhje me sigurimet e detyrueshme motorike ku përfshin një sërë komponentësh siç janë: regjstri i policave të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe regjstri i dëmeve në shërbim të sistemit Bonus Malus;
- Realizon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave në kohe reale;
- Realizon dhe bën të mundur lidhjen me regjistra të tjerë kombëtare, i mirëmban dhe jep informacion për palë të treta;
- Përgjigjet për draftimin dhe zbatimin e marrëveshjeve mbi bazë të teknologjisë së informacionit me palë të treta;
- Siguron vazhdimësinë e sistemeve dhe përgjigjet për saktësinë dhe ruajtjen e informacionit dhe arkivimin e tij.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve

Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve

- Shqyrton dhe trajton kërkesat dhe dokumentacionin për licencim e subjekteve në tre fushat e mbikëqyrjes;
- Shqyrton dhe trajton kërkesat për miratime gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve (ndryshime të administratorëve/anëtarëve të këshillave, pjesëmarrje influencuese, statute, delegim funksionesh, shtrirje jashtë vendit, bashkime, etj.);
- Trajton përputhshmërinë e prospekteve (për emetim titujsh, për fondet e investimit dhe fondet e pensionit) me kërkesat rregullative;
- Mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësve që ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimeve (agjentë, vlerësues, broker dhe operatorët e tjerë të ndryshëm nga shoqëritë e sigurimit/risigurimit);
- Mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësve që ushtrojnë aktivitet në tregun e titujve (broker, agjentë të lidhur, këshilltarë, regjistrare, QRAetj.);
- Mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësve që ushtrojnë aktivitet në tregun e fondeve të pensionit dhe investimit (agjentë kuotash, etj.);
- Monitoron tregjet e rregulluar të titujve (Bursa / tregu me pakicë).

4. Departamenti i Çështjeve Juridike

Drejtoria e Zbatueshmërisë

- Ndjek zbatueshmërinë e akteve rregullative dhe atyre administrative nëpërmjet propozimit të masave korigjuese apo administrative;
- Ndjek zbatimin e masave disiplinore të vendosura nga Autoriteti;
- Ndjek zbatimin e legjislacionit nga subjektet e licencuara nga Autoriteti gjatë veprimtarisë së ushtruar prej tyre;
- Ndjek funksionet administrative të BSHS;
- Shqyrton dhe ndjek procedurat lidhur me administrimin e përkohshëm, likuidimin dhe falimentimin, shkrirjen / bashkimin e subjekteve në bashkëpunim me strukturat e tjera të Autoritetit;
- Përfaqëson Autoritetin në konfliktet gjyqësore;

- Monitoron sjelljen në treg të subjekteve të mbikëqyrura;
- Monitoron trajtimin e konsumatorëve si pjesë integrale e kulturës së biznesit, duke filluar që nga monitorimi i mënyrës së dhënies së informacionit nga ana e subjekteve, analizë e kushteve të përgjithshme të kontratave deri në ndërmjetësim në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve;
- Monitoron veprimtarinë promovionale të subjekteve që mbikëqyren;
- Trajton ankesat nga konsumatorët apo investitorët, jep informacion personave të interesuar sipas parashikimeve ligjore.

Drejtoria Juridike

- Drafton akte ligjore dhe nënligjore, si dhe rishikimin e atyre në fuqi;
- Jep opinion juridik mbi projekt-aktet normative të dërguara për mendim nga organet apo subjekte të tjera;
- Informon organet vendimmarrëse të Autoritetit në lidhje me ndryshimet në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e Autoritetit;
- Evidenton efektet dhe implikimet ligjore dhe përgatit përshtatjen e akteve ligjore të AMF-së në këte kuader;
- Ndjek miratimin e paketave ligjore të propozuara në organet eprore, ministri dhe kuvend;
- Drafton marrëveshje të ndryshme, memorandume, protokolle bashkëpunimi apo shkëmbimi, kontrata ligjore dhe çdo dokument tjetër ligjor në mbështetje të aktivitetit të AMF-së;
- Ndjek problemet që lidhen me zbatimin e ligjit për luftën kundër pastrimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit, ligji për mbrojtjen e të dhenave personale, ligjit për informimin, etj;
- Trajton aspektet e ligjshmërisë së aktivitetit të vetë AMF-së;
- Jep opinione ligjore për Bordin e AMF-së;
- Jep asistencë departamenteve apo njësive të tjera me qëllim mbrojtjen ligjore të institucionit;
- Jep opinionin juridik mbi përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator të materialeve objekt vendimmarrjeje dhe të gjithë veprimtarisë së AMF-së;
- Merr pjesë në grupet e inspektimit.

Drejtoria e Rregullimit dhe Standardeve

- Ndjek zhvillimet e standardeve dhe direktivave për tregjet financiare jo bankare;
- Propozon ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore në përputhje me këto direktiva dhe parime ndërkombëtare;
- Bashkëpunon me organizmat ndërkombëtare financiare për implementimin e rekomadimeve dhe orientimeve të tyre në lidhje me zhvillimin e tregjeve financiare jobankare;
- Bashkëpunon me Ministrinë e Integritit për zbatimin e Planit Kombëtar të Integritit si dhe me Bankën e Shqipërisë;
- Bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare të IAIS, IOSCO, IOPS, EIOPA, ESMA, OECD;
- Harton tabelën e përputhshmërisë me direktivat e BE-së për aktet ligjore dhe nënligjore.

5. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme

- Mbështet veprimtarinë e institucionit, në krijimin e kushteve normale të punës për të gjithë administratën e Autoritetit;
- Administron vlerat materiale dhe monetare të institucionit;
- Përdor me efektivitet burimet financiare të Autoritetit;
- Harton strategjinë/politikat e punësimit, për të siguruar burime njerëzore me integritet dhe të afta profesionalisht;
- Harton dhe ndjek planin financiar afat-shkurter dhe afat-mesëm të AMF-së;
- Koordinon punën për vendosjen e sistemeve të menaxhimit të kontrollit financiar;
- Zbaton rregullat dhe ligjete menaxhimit financiar dhe kontrollit për të siguruar menaxhim më të mirë dhe me efektshmëri të burimeve financiare të institucionit;
- Zbaton normat tekniko - profesionale të protokollit dhe arkivës;
- Ndjek procedurat e prokurimit,
- Trajton ankesat në lidhje me procedurat e prokurimit.

- Përgjigjet për sigurinë e ambjenteve të institucionit dhe mirëmbajtjen e tyre.

6. Qendra e Edukimit

Qendra e Edukimit

- Organizon trajnime të nevojshme për formimin profesional para-licencimit të drejtuesve dhe profesionistëve që operojnë në tregjet financiare që mbikëqyren;
- Organizon trajnime të nevojshme për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve;
- Organizon trajnime për punonjësit e Autoritetit për të siguruar rritjen e cilësisë mbikëqyrëse dhe rregullatore;
- Rekruton trajnerë me anë të programit “train the trainers” me njohuritë në fushat përkatëse në Shqipëri apo jashtë vendit;
- Përgatit planet e trainimit dhe bazën materiale në funksion të trainimeve.